



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 125 dt.28.04.1994

**PER**  
**EMERIMIN E KESHILLIT DREJTUES TE NDERMARRJES**  
**PERPUNIMIT DHE KONFEKSIONIMIT LEKUREVE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.28.04.1994, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura nga Seksioni i Prognozës, për emërimin e Këshillit Drejtues të kësaj ndërmarrje, duke u mbështetur në ligjin “Për ndërmarrjet shtetërore”, Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.2 dhe të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10,

**VENDOSI**

1. Emërimin e Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Përpunimit dhe Konfeksionimit të Lëkurëve me punonjësit e poshtëshënuar :
  - 1.Sulejman Mëniku
  - 2.Ermira Lazimi
  - 3.Vojsava Pullazi
  - 4.Aishe Seseri
  - 5.Mynevere Fejzo
2. Mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.107, dt.18.02.1994 u bë bashkimi i ish dy ndërmarrjeve, të

Përpunimit të Lëkurëve dhe të Konfeksionimit të Lëkurëve në një ndërmarrje në Ndërmarrjen e Përpunimit dhe Konfeksionimit të Lëkurëve. Me daljen e këtij vendimi pushojnë së qëni dhe Këshillat drejtuese të këtyre ndërmarrjeve.

3. Pagat e drejtorit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Përpunimit dhe Konfeksionimit të Lëkurëve, mbetet në fuqi paga e aprovuar më parë për ish Ndërmarrjen e Përpunimit të Lëkurëve (paga e aprovuar si ndërmarrje që punon me lëndën e parë të porositësit).
4. Ngarkohet Seksioni i Prognozës për zbatimin e këtij vendimi.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**